



NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E PRETENDUAR TË ASETIT

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

MIT154 Njësia Punuese e Ndërmarrjes Cineoptic Novi Sad në Mitrovicë

Preduzece za Promet i Usluge Kino opt.apar. "Cineoptic" Novi Sad

Drustveno Preduzece za promet kino, foto i optickim proizvodima "Cineoptic" Novi Sad

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i asetit të lartpërmendura ka filluar me datë 11 janar 2018 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 14 dhe 15 dhjetor 2017.

Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj asetit të Njesisë Punuese të sipërpërmendur, duhet të parashtrojë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.

Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 18 janar 2018 dhe përfundon me datë 5 mars 2018 në orën 16:00.

Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje të kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.

Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit Zyra Rajonale në Mitrovicë

Mbretëresha Teutë, pn (afër Sallës së Sporteve),

Mitrovicë, 40 000

Telefoni: +381 28 534 690

Fax: +381 28 534 590

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faja e internetit të AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni **"Formularët-Udhëzime për plotësim"**. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.